

## **ZV/KRYEREGJISTRYUES**

I lindur më 1 Korrik 1976, në Tiranë.

Është arsimuar në Fakultetin Juridik, në Tiranë, dhe ka kryer studimet pasuniversitare, për Master Turizëm dhe Ekonomi, në Shkollën Ndërkombëtare të Shkencave, Romë – Itali, si dhe Master për Marrëdhënie Ndërkombëtare e Europiane në Institute de Recherches et d’Etudes en Relations Internationales e Europeennes, Francë (Instituti i Kërkimit në Marrëdhënie Ndërkombëtare dhe Europiane). Ka filluar karrieren e tij në Ministrinë e Bashkëpunimit Ekonomik dhe Tregtisë, si Jurist në Sekretariatit Shqiptar për Koordinimin e Marrëdhënieve me OBT, dhe më pas si Shef Sektori për tregtinë në mallra, duke mbuluar:

-Të gjitha marrëveshjet për tregtinë në Mallra të Raundit të Uruguait, e cila themeloi Organizatën Botërore të Tregtisë (OBT),

-Marrëveshjet e Tregtisë së Lirë (MTL) me vendet e Rajonit, në kuadër të Memorandumit për Liberalizimin dhe Lehtësimin e Tregtisë të Paktit të Stabilitetit, si negociator i palës shqiptare në to.

Ka hartuar Strategjinë e negociimit, për Shqipërinë, në procesin e anëtarësimit në OBT dhe për të gjitha MLT-të e negociuara.

Në Gusht të vitit 2003 emërohet Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Ekonomisë. Ka qenë përfaqësues zyrtar i Shqipërisë në Programet e Bashkëpunimit Ndërkufitar INTERREG III A Transfrontaliera Adriatiko, si dhe INTERREG III A, Greqi – Shqipëri.

Nga muaji Qershor 2004, deri në Janar 2006, është emëruar Sekretar i Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë. Prej Muajit Shkurt 2006 ka ushtruar profesionin e Avokatit.

Nga Shtatori i vitit 2012, deri në Gusht 2013 ka qenë Administrator i Universitetit jo Publik “Sevasti dhe Parashqevi Qiriazi”, Tiranë.

Njeh shumë mirë gjuhët e huaja anglisht, frëngjisht dhe italisht.

Qe nga muaji tetor 2013, mban postin e Zv.Kryeregjistruesit.

## **ZV/KRYEREGJISTRYUES**

### **BESNIK HYSENBELLI**

I lindur 19 Janar 1972 ne Skrapar

Ne vitin 1996 u diplomua ne Akademinë e Arteve, „Specialiteti Pikturë dhe ne vitin 2008 u diplomua ne Universitetin Politeknik te Tiranës, Fakultetin e Inxhinierisë se Ndërtimit, Dega Arkitekture.

Qe nga muaji dhjetor 2009, mban postin e Zv.Kryeregjistruesit